FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

**[03 Maj 2017]**

Për: **"SHANSI INVEST" sh.p.k** **K61716013M** Adresa: Tiranë, Nj.Bashkiake Nr.9, Rr.Muzaket

Procedura e prokurimit: ***Proçedurë e hapur-Punë, rruge elektronike;***
Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rehabilitimi i Rruges se Fshatit Zahrisht, Has"**
Fondi Limit: **126,785,883.0 (Njëqind e njëzet e gjashtëmilion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e tetedhjete e tre) lekë, pa TVSH (Vlera e plotë e Projektit)**

Afati per realizimin e punimeve: **210 ditë** nga lidhja e kontrates, detajuar përkatësisht ***sipas*** fazave te financimit te **KZHR per llogari t**e buxhetit bashkisë Has për Publikime të mëparshme (nëse zbatohet):
Buletini i Njoftimeve Publike *[Njoftim Kontrate,* ***Buletini Nr 6, date 13.02.2017]***
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ***Çmimi më i ulët X;***

Data e zhvillimit te tenderit: ***03.03.2017, ora 16:00;***

Burimi i Financimit: ***Buxheti Shtetit (sipas* VKZHR Nr.08, dt.13.02.2017** bashkisë Has);

Bazuar ne Nenin 58/2 te ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), nenit 21, 69 të VKM nr.914, date 29/12/2014 (i ndryshuar) "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ***"BOSHNJAKU.B" Sh.p.k K72627402H***

***Vlera 110,833,100 (Njëqind e dhjetëmilin e tetëqind e tridhjetë e tremijë e njëqind) leke pa tvsh***

2. ***"CAUSHI" Sh.p.k J97511807W***

***Vlera 0.0 (Nuk ka paraqitur ofertë)leke pa tvsh.***

3. ***"PE-VLA-KU" Sh.p.k K61716013M***

***Vlera 126,038,355 (Njëqind e njëzet e gjashtëmilion e tridhjetë e tetëmijë e treqind e pesëdhjetë e pesë)leke pa tvsh***

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. ***"BOSHNJAKU.B" Sh.p.k*** për arsyet e mëposhtme:

- *Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik me vlere 110,833,100 Leke pa tvsh dhe 155,166,340 Leke me tvsh, ka gabime aritmetike qe e kalon vleren 2% të ofertes ekonomike të ofertuar, konkretisht e shprehur ne perqindje* **14,28 %.** *Oferta e korrigjuar eshte 110,833,100 Leke pa tvsh dhe 132,999,720 Leke me tvsh, ose 22,166,620 Leke me pak sesa vlera e ofertes se operatorit ekonomik. Sipas DST pika 3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra, 3.2.3 Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*
- *Nuk ploteson piken 2 te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur nje dokument qe verteton se: a)ka plotesuar detyrimet fiskale,b)ka paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqerore, te leshuar nga Administrata Tatimore.*
- *Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.2.c te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi nuk ka paraqitur vertetim qe te deshmoje se disponon vlere te mjaftueshme monetare per te realizuar objektin e tenderit pa marre paradhenje. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga një ose më shumë banka për gjendjen financiare në vlerë jo më të vogël se 10 % te vleres se fondit limit, të lëshuar jo më pare se 5 (pese) ditë nga dita e hapjes së ofertave.*
- *Nuk ploteson piken 2.2.d te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruara, kryen aktivitet ne Gjirokaster nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.*
- *Nuk ploteson piken 2.2.e te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, nuk ka paraqitur nje dokument qe verteton se ka plotesuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore prane Bashkise HAS.*

Open Procurement Albania

- *Nuk ploteson piken 2.3.c te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me stafin drejtues, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per stafin teknik: 3 (tre) inxhinier ndertimi; 1 (nje) inxhinier ndërtimi me profilin transport; 1 (nje) inxhinier topograf/gjeodet.*
- *Nuk ploteson piken 2.3.e te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me licencen profesionale, pasi nuk disponon pikat e licences: NP-4G Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale; NP-5G Punime nentokesore, vepra arti; NS-1D Punime per prishjen e ndertimeve; NS-6C Sinjalistika rrugore jo ndriçuese; NS-7C Barrierra dhe mbrojtje rrugore.*
- *Nuk ploteson piken 2.3.f te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me disponimin e makinerive dhe pajisjeve, pasi nuk disponon mjetet: Grejder 1 cope; Gurethyese, Frontoje 1 cope; Fabrikë asfalti jo me larg se 30 km nga Objekti i Prokurimit 1 fabrike; Rrul gome–hekur mbi 12 ton 2 cope; Rrul hekur–hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton) 1 cope; Rrul asfalti me gome-gome 2 cope; Furçe mekanike për pastrim (fshese) 1 cope; Autobot uji 1 cope; Freze asfalti 1 cope; Mjet autovinç 1 cope; Buldozer 1 cope*

***a)*** *Për paisjet teknike, kur jane në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur jane me qera duhet të paraqiten kontratat e qerase, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat qe nuk jane sipas formatit te miratuar me tvsh (faturat e biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.*
***b)*** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshem i mjetit dhe fotot e tyre. Kur jane me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerase, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshem i mjetit dhe fotot e tyre.*
***c)*** *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fatura tatimore perkatese. Kur jane me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerase, kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese.*

- *Nuk ploteson piken 2.3.h te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me detyrimin per te paraqitur vertetim ( te leshuar nga Bashkia Has) per kryerjen e vizites ne kantjer.*

2. ***"CAUSHI"Sh.p.k Nuk ka paraqitur ofertë.***

Open Procurement Albania

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine ***"PE-VLA-KU" Sh.p.k*** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej ***126,038,355 (Njëqind e njëzet e gjashtëmilion e tridhjetë e tetëmijë e treqind e pesëdhjetë e pesë) leke pa tvsh*** është identifikuar si oferta e suksesëshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkia Has sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, ***brenda 30 (tridhjetë) ditëve*** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

*Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë* ***25.04.2017.***

**Ankesa:** Jo, nuk ka patur

**Adem LALA**
[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]